



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISE, KULTURES DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “KRISTO ISAK” BERAT**

Nr. 25/1 prot.

Berat, më 30.09.2024

**Lënda:** Njoftim për vend të lire pune

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerzore

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhezimit nr. 14 date 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional " Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak” ju njofton për krijimin e vendit të lirë për pozicionin mësues:

- 1- Mësimdhënës i formimit teorik-praktik, drejtimi Shërbim Social dhe Shëndetësor - 1 (një) mësues zëvendësues leje lindje.
- 2- Mësimdhënës i formimit teorik-praktik, drejtimi Hoteleri-Turizem/Ekonomi Biznes, 1 (një) mësues.
- 3- Mësimdhënës i formimit teorik-praktik, drejtimi Hoteleri-Turizëm, me kohë të pjesshme, 1 (një) mësues.

**II- Aplikantët për mësimdhënës të kulturës profesionale të ofruesit e AFP-së duhet të përmbushin këto kritere:**

**1.2 Kritere të përgjithshme:**

- 4- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 5- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- 6- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;

- 7- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- 8- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- 9- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivim.

**Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë&praktikës profesionale në ofruesit e AFP-ë,që ofrojnë arsim të mesëm profesional:**

- d) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- e) Të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- f) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

**II. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- l) letërmotivimin për pozicionin;
- m) jetëshkrimin (CV-në) sipas modelit Europass,
- n) kartën e identitetit;
- o) diplomën e studimeve universitare;
- p) librezën e punës;
- q) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- r) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- s) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- t) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- u) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- v) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brënda datës. 08.10.2024.

**DREJTORI I SHKOLLËS**

**Ferik KOÇI**

